REPUBLIKA E KOSOVËS **KOMUNA E LIPJANIT**
REPUBLIKA KOSOVA **OPŠTINA LIPLJAN**
REPUBLIC OF KOSOVO **MUNICIPALITY OF LIPJAN**

Datë:	10.12.2020
Referencë:	
Për:	z.Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	z.Fauz Xhemajli – Nënkryetar i Komunës z.Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës
Nga:	Nazim Gashi - Drejtor i DMSH-së
Lënda:	Raport mujor per muajin nëtorë 2020.

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIT.

Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim ka vazhduar të kryej punët dhe detyrat që ka në bazë të ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
Në fillim të muajit nëntor është hartuar plani mujorë i punës në bazë të planit vjetor të punës dhe janë caktuar prioritetet me të cilat DMSH do të merret gjatë muajit nëntorë.

Edhe muaji nëntor është karakterizuar me temperatura normale dhe reshje të shiut e cila ka qenë në kuotën minimale dhe nuk ka krijuar ndonjë kërcënim për vërshime eventuale.

Sa i përket kërcënimit nga vërshimet situata ka qenë normale dhe nuk kemi pasur ndonjë rast të vërshimit.

Sa i përket kërcënimit nga zjarret situata ka qenë nën kontrollë përkundër faktit që kemi pasur numër të konsiderueshëm të zjarreve të ndryshme të cilat i kemi menagjuar dhe kemi intervenuar në të gjitha thirrjet për ndërhyrje emergjente.

Të gjitha aktivitete janë zhvilluar duke respektuar me përpikëri masat mbrojtëse nga pandemia covid19.

Janë kryer edhe të gjitha aktivitet e tjera të cilat ka DMSH si: pagesat për shpenzime të karburanteve për NjPZSH dhe obligime tjera.

Janë pranuar numër i konsiderueshëm i kërkesave të ndryshme të cilat bien në domenin e DMSH-së dhe të gjitha këto kërkesa janë trajtuar me kohë duke respektuar edhe afatet ligjore

.

Në javë e parë të muajit nëntor është organizuar dhe mbajtur takimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në këtë rast drejtori i DMSH-së ka përgatitur një raport dhe ka paraqitur para anëtarve të KKSB-së.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE.

Nga NjPZSH intervenime të teren kemi pasur:

Zjarre --- 13

Intervenime teknike ----- 1

Prerje drunjesh - 1

Ushtrim me nxenes ne aeroport - 1

Sherbim - 1

Gjithsej - 17 intervenime .